



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 292/7 Prot.

Tiranë, më 12 . 05 . 2025

V E N D I M

Nr. 121, Datë 12 . 05 . 2025

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 36, datë 12.02.2025, të znj. M. S., ku pretendohet diskriminim për shkak të “gjendjes shëndetësore” dhe “aftësisë së kufizuar” nga ana e Policisë Bashkiake, Bashkia Shkodër.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues, ndër të tjera, informon se: *“Unë, nënshkruesja M. S., jam person invalid paraplegjik me probleme shëndetësore dhe jetoj e vetme. Kam bërë ankesë tek KMT-ja dhe më dërgoi Policia Bashkiake e Shkodrës, e cila më ka sorollatur jo sot po nesër, por deri tani nuk kanë marrë asnjë veprim për problemin tim, pavarësisht ankesës që kam bërë. Arsyeja pse kam bërë ankesë pranë Policisë Bashkiake Shkodër është se komshija e katit të tretë ka bllokuar garazhin e përbashkët të pallatit me sendet e veta, duke më lënë hapësirën e lirë që të vendos motorin tim, të cilin e përdor për shkak të gjendjes time të invaliditetit, pavarësisht se ajo është një hapësirë publike. Gjithashtu, doja të theksoja faktin se Policia Bashkiake ka refuzuar të më japë një kopje të ankesës që kam bërë para disa kohësh dhe ka neglizhuar në mënyrë të vazhdueshme kërkesat e mia”.*

Sa më sipër, pala ankuese kërkon nga Komisioneri konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e masave nga ana e Policisë Bashkiake Shkodër për zgjidhjen e kësaj mosmarrveshje.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës nr.36 Regj., datë 12.02.2025, paraqitur nga znj. M. S., u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 292/1 prot, datë 17.02.2025, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga Policia Bashkiake, Bashkia Shkodër, për ankesën e bërë nga znj. M. S., si mëposhtë vijon:
 - Parashtrimet tuaja lidhur me pretendimet e ankueses, znj. M. S.
 - Kopje të kërkesave të bërë nga ankuesja, si dhe kopje të përgjigjeve të kthyer nga ana e Policisë Bashkiake Shkodër.
 - Informacion lidhur me qëndrimin e mbajtur nga ana juaj, sipas rekomandimeve të dhëna nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Shkodër, sipas shkresës nr. 1138/6 prot., datë 08.07.2024, lidhur me trajtimin e problematikës së zonjës S.
 - Informacion lidhur me veprimet e ndërmarra nga ana juaj për zgjidhjen e këtij problemi.
 - Çdo informacion tjetër që ju do ta gjykoni të arsyeshëm dhe që do të ndihmonte në sqarimin e plotë të kësaj çështjeje.
- Me shkresën nr. 292/2 prot, datë 17.02.2025, është administruar pranë Komisionerit, shkresa nr.6453 prot., datë 21.03.2025 e Bashkisë Shkodër, ndër të tjera, informon se:
Në vijim të trajtimit të ankesës është deleguar për kryerjen e veprimeve verifikuese punonjësi i Policisë Bashkiake z. A. B., i me detyrën Shef sektori. Në asnjë rast shtetasja M. S. nuk është diskriminuar për shkak të gjendjes së saj shëndetësore apo fizike por është pritur në ambientet e Bashkisë Shkodër/Drejtorisë së Policisë Bashkiake, është sqaruar për situatën, është drejtuar që të bëjë ankesën me shkrim pranë zyrës me një ndalesë ZIN dhe është administruar formalisht ankesa me shkrim me datën 16.12.2024 për të lënë gjurmën për ankesën në sistem. Për trajtimin e ankesës po kryhen veprime verifikuese në vend, juridikisht për të zgjidhur rastin. Është verifikuar në vend hapësira për të cilën ka lindur konflikti, është fotografuar. Paralelisht me veprimet verifikuese është marrë kontakt menjëherë me palën tjetër Znj. F. K., e cila ishte banore e katit të tretë të pallatit ku banonte edhe ankuesja. Takimi është kryer në prani të punonjësve të administrimit të lagjes Nr.2, me qëllim trajtimin e mundshëm të rastit si konfliktit dhe zgjidhjes paqësore me marrëveshje mes palëve. Shtetasja F. K., deri tani është takuar disa herë por është shprehur se në katin e parë të pallatit ku jeton kishin vendosur para shumë viteve një derë në sheshpushimin e katit të parë me qëllim mbrojtjen e pompës së përbashkët të ujit (që ndodhej aty), ky ambient shfrytëzohet prej saj dhe një komshije tjetër në atë pallat për të siguruar biçikletat, nuk kanë patur asnjë kundërshtim më parë nga banorët e tjerë të pallatit dhe dera ishte vendosur me dakordësinë e tyre. Në kuadër të trajtimit të çështjes

në këtë fazë jemi të detyruar t'ju sqarojmë bazën ligjore mbi të cilën po punon Policia Bashkiake:

Në ligjin nr. 89/2022, konkretisht në nenin 9 pika 3 thuhet: “Në fushën e bashkëjetesës shoqërore, Policia Bashkiake: a) mbikëqyr respektimin e normave etike detyruese të bashkëjetesës, të përcaktuara në rregulloren e administrimit të bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit; b) mbështet organet e inspektimit për zbatimin e legjislacionit për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit;” vijon...

Në ligjin 10112, datë 09.04.2009 “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” përcaktohet si “Inspektoriat vendor” mes të tjerëve dhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit (ish INUV) për detyrat që ka vetë ky inspektorat në fushën e ndërtimit, shpjegohen në ligjin 9780/2007. Megjithëse Policia Bashkiake nuk ka tagër veprimi në fushën e ndërtimit por vetëm përcjell konstatimet në këtë fushë IMT-së vendore.

Në këtë rast kemi të bëjmë me ndërtim të kahershëm me mur e derë. Pavarësisht këtyre citimeve më sipër, e kemi trajtuar çështjen bazuar në rregulloren tip “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” miratuar me VKM 447 datë 16.06.2010, kemi vepruar në linjën e konfliktit në drejtimin sipas nenit 35 “Zgjidhja e konflikteve” ku citohet: “1. Bashkëpronarët mundohen t’i zgjidhin konfliktet me mirëkuptim dhe kur nuk arrihet mirëkuptimi, sipas përkatësisë përkatëse, administratori ose njëri prej bashkëpronarëve mund t’i drejtohet njërit prej organeve më poshtë: a) Policisë bashkisë/komunës për mosrespektim të normave detyruese sipas nenit 34 kreu VII: sipas kuptimit të thjeshtuar për rastet kur hapësira është e zënë me mjete si biçikleta etj., e jo me ndërtime; b) Inspektoratit vendor ndërtimor urbanistik (sot njihet si IMT) për ndërhyrje të pa miratuara në pjesët apo objektet e pronës së përbashkët;” vijon...

Për të mos cituar çdo gërmë të nenit 34 “Norma detyruese, rregulla të përgjithshme të marrëdhënieve ndërmjet bashkëpronarëve” po citojmë vetëm pikën 3: “Rregulla të përdorimit të mjediseve të përbashkëta”; t) Zonat e përbashkëta brenda ose jashtë godinës së banimit, si shkallët, sheshpushimet, tarracat, verandat e përbashkëta, lulishtet dhe vendkalimet nuk do të përdoren për ruajtje, parkime ose të bllokohen.g) Asnjë mjet motorik, biçikletë, lodër, kazanë, shkallë, mobilie, kosha plehrash, ose sende të tjera personale nuk duhet të bllokojnë rrugët e hyrjes, vendkalimet, parkingun ose zona të tjera të përbashkëta të përshkruara në këtë pikë. Në këtë kuptim Policia Bashkiake megjithëse nuk ka tagër në shqyrtimin e ndërtimeve pa leje (përveç konstatimit), po punon që të arrihet marrëveshje mes palëve pasi, sikurse citohet më sipër, nuk ka të drejtë asnjë prej bashkëpronarëve të zërë hapësirat e përbashkëta me përcaktimet e germës g. Po ashtu jemi në fazën e bashkëpunimit me IMT, administrimin e lagjes dhe të tjerë, për të zgjidhur problemin sipas ligjit pa ndërmarrë hapa që do të krijojnë shkelje të të drejtave. Ju sigurojmë se në asnjë rast shtetasja nuk është diskriminuar, po ashtu në asnjë rast nuk ka kërkuar kopje të ankesës/ave pranë Policisë Bashkiake. Në përfundim të trajtimit dhe zgjidhjes së ankesës do t’ju njoftojmë për mënyrën e zgjidhjes.

- Me shkresën nr.292/3 prot., date 12.02.2025 të Komisionerit i është përcjellë ankueses shkresa nr.6453 prot., date 21.03.2025 e Bashkisë Shkodër, për të bërë parashtrimet e saja

në lidhje me këtë përgjigje, por ankuesja nuk ka dërguar asnjë përgjigje në lidhje me të pranë Komisionerit.

- Me shkresën nr.292/4 prot., date 23.04.2025 të Komisionerit i është kërkuar informacion dhe shpjegime shtesë Policisë Bashkiake, Bashkia Shkodër në lidhje me veprimet e tyre si dhe të gjithë informacionin në lidhje me procedurën e ndjekur, informacion i cili duhet të shoqërohet me prova konkrete (përgjigje me shkrim, procesverbale konstatimi, vendime, etj.)
- Me shkresën nr. 292/5 prot, datë 30.04.2025, është administruar pranë Komisionerit, shkresa nr.6453/2 prot., datë 29.04.2025 e Bashkisë Shkodër, ndër të tjera, informon se:

Që në momentin e parë të procedurës, në datë 15 të muajit janar 2025 është verifikuar në vend ankesa. Kemi takuar gjatë muajve janar — shkurt ankuesen. Është identifikuar shtetasja F. K., e cila është banore në të njëjtin pallat me ankuesen. Nga ana jonë, pas disa kontrolleve të situatës, kemi kontaktuar disa herë shtetasen në fjalë, kemi kërkuar trajtim të çështjes me marrëveshje, referuar akteve ligjore në fuqi, por nuk është arritur dakordësia. Ju sqarojmë se ligji për banesat/pallatet parashikon fakt të kryer qenien e administratorit, gjë që mungon pasi banorët nuk kanë zgjedhur të tillë. Është verifikuar statusi i pronës, koha e ndërtimit të murit, vendosjes së pompës së përbashkët.

Nga ana e punonjësve të Policisë Bashkiake, për rastin në fjalë është përpiluar Akt-Konstatimi, me numër serie 0001296, datë 04.04.2025, në ngarkim të shtetas F. K., banuese në katin e tretë, e cila kishte vendosur një derë metalike në sheshpushimin e katit të parë dhe iu la afat 7 (shtatë) ditë për lirimin e hapësirës dhe heqjen e derës. Kopja e aktit të konstatimit është dorëzuar dhe firmosur nga vetë shtetasja në fjalë, si dhe njoftimi zyrtar për afatin dhe detyrimin për të rikthyer hapësirën në gjendjen fillestare.

Me shkresë nr. 1541/b, datë 17.04.2025, Drejtorisë së Aseteve dhe Kadastrës Urbane pranë Bashkisë Shkodër, është kërkuar informacion në lidhje me statusin juridik të pronës, që të bëhet e mundur nga ana jonë trajtimi i kësaj ankese, si dhe të na saktësojë nëse është pjesë e hapësirës së përbashkët që është në përdorim të gjithë banorëve. Në përgjigjen e kthyer nga kjo drejtori me shkresën nr. 1541/b, datë 17.04.2025, konfirmohet se: Në zbatim të ligjit nr. 10112, datë 09.04.2009, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit”, hapësirat e brendshme të pallateve janë ambiente të përbashkëta dhe banorët janë bashkëpronarë të këtyre ambienteve në mënyrë proporcionale, ndërsa për statusin juridik të pronës, ky informacion merret pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Shkodër.

Nga ana jonë është marrë takim disa herë me shtetasen F. K., e cila është shprehur se arsyeja e vendosjes së derës vite më parë në sheshpushimin e katit të parë të pallatit është mbrojtja e pompës së përbashkët të ujit, si dhe shfrytëzohet prej saj dhe një komshije tjetër në këtë pallat për të siguruar biçikletat, dhe se nuk ka pasur kundërshtim më parë nga banorët e tjerë të pallatit, dhe se dera ishte vendosur me dakordësinë e tyre. Raste të ngjashme të zënies së hapësirave të

përbashkëta në hyrjet e pallateve janë të pranishme në shumë ndërtesa (pallate) në të gjithë territorin e Qarkut Shkodër.

Theksojmë me përgjegjësi të plotë se në asnjë moment nuk është kryer apo toleruar ndonjë formë diskriminimi ndaj shtetases në fjalë për shkak të gjendjes së saj shëndetësore apo statusit si person me aftësi të kufizuara. Takimi i fundit me shtetasen M. S. ka qenë me datë 29.04.2025, të cilën e kemi sqaruar për veprimet që do të merren nga ana jonë në zgjidhjen e çështjes dhe se kemi pasur mirëkuptimin e saj.

Policia Bashkiake do të vazhdojë të ndjekë me prioritet këtë rast në bashkëpunim me strukturat përgjegjëse dhe do t'ju informojmë mbi zbatimin e masave të vendosura për rikthimin e hapësirës në gjendje të mëparshme.

Bashkëlidhur shkresës ju dërgojmë:

- Fotokopje të Akt-Konstatimit me nr. serie 0001296, datë 04.04.2025.
- Fotokopje shkresash dhe përgjigjja e Drejtorisë së Aseteve dhe Kadastrës Urbane
- Me shkresën nr.292/6 prot., date 02.05.2025 të Komisionerit, bazuar në nenin 33/8, të LMD, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, komisioneri zhvillon një seancë dëgjimore publike dhe fton palët dhe çdo person tjetër të interesuar”, si dhe për të sqaruar të gjitha faktet dhe rrethanat e çështjes, Komisioneri njoftoi palët dhe caktoi datën 08.05.2025, ora 10:00, për zhvillimin e seancës dëgjimore.

Në vijim të shkresës nr. 292/6 prot., datë 02.05.2025, është administruar pranë Komisionerit, nëpërmjet email-it të përfaqësuesit të Zyrës Rajonale Shkodër, një deklaratë nga znj. M. S. Në këtë deklaratë, ajo informon Komisionerin se tërhiqet nga ankesa nr. 36 Regj., datë 12.02.2025, për shkak të arritjes së efektivitetit në zgjidhjen e çështjes.

Znj. S. sqaron se, nga ana e Bashkisë Shkodër, pas paraqitjes së ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, janë ndërmarrë hapa konkretë për zgjidhjen e situatës. Janë bërë njoftime përkatëse dhe është mbajtur Akt-Konstatimi, (*dokumentacion i cili është përcjellë pranë Komisionerit*) në të cilin është përcaktuar një afat nga Bashkia. Palët janë dakordësuar që, pas përfundimit të afatit të njoftimit, do të veprohet sipas procedurës së parashikuar nga ligji për lirin e objekteve të përbashkëta.

Në këto kushte, Komisioneri vlerëson se, qëllimi për të cilin ishte filluar hetimi administrativ është përmbushur në thelb, dhe në referencë të nenit 33, pika 9, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër së cilit është paraqitur ankesa”, KMD vlerëson se është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin ishte iniciuar ankesa.

Në nenin 90/3 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë” parashikohet përfundimi i procedurës administrative: “Procedura administrative, e nisur me kërkesë apo kryesisht, deklarohet e përfunduar pa një vendim përfundimtar për çështjen, në rastet e parashikuara në nenet 93-96 të këtij Kodi. Deklarata e përfundimit të procedurës administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen, përbën akt administrativ”.

Njëkohësisht, në referencë të nenit 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon se: “Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”, Komisioneri deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenin 90/3 dhe 94/1, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, nenin 1, nenin 7, pika 1, neni 20 dhe 21, pika 1, nenin 32, pika 1, shkronja a) e nenin 33, pikat 9-10, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr.36 Regj., datë 12.02.2025, paraqitur nga znj. M. S., pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi, për të cilin kishte filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA